



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 259/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Malishevë, paraqitur kundër subjektit politik Nisma për Kosovë dega në Malishevë, për shkak të blerjes së votave gjatë ditës së zgjedhjeve në qytetin e Malishevës, në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2014 mori këtë:

VENDIM

I. Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

II. Nisma për Kosovën i shqiptohet dënimi më gjohë në vlerë prej 3000 (tremijë) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

III. Ardian Mazrekut nga subjekti Nisma për Kosovë, i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 5 vite nën autoritetin e KQZ-së si kandidat i Nismës për Kosovën ose i ndonjë partie tjetër, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 08.06.2014 ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik PDK dega në Malishevë në të cilën theksohet se aktivistët e subjektit politik PDK kanë vërejtur se në qytetin e Malishevës konkretisht në vendvotimin në shkollën fillore “Hamdi Berisha” aktivisti i subjektit politik Nisma për Kosovë Ardian Mazreku profesor i edukatës fizike, bashkë me një grup të militantëve të Nisma për Kosovë, ju kanë ofruar qytetarëve ryshfet për blerjen e votave. Andaj me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime janë në kundërshtim me nenin 33 pika f) të LZP-së.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik Nisma për Kosovë për ankesën që është bërë ndaj saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës në fjalë deri më datë 10.06.2014 deri në ora 09:00

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik Nisma për Kosovë, në të cilën përgjigje theksohet se personi në fjalë Ardian Mazreku nuk është marrë nga policia në vendvotimin ku thuhet, por se ai është marrë jashtë qendrës së këtij vendvotimi diku në një lokal në qytet dhe se nuk është marrë për shkeljen për të cilin

pretendon pala ankuese, dhe se ankesa në fjalë nuk ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme për tu vërtetuar ato pretendime ankimore.

Lidhur me këtë çështje PZAP-i e informoi Policinë e Kosovës dhe kërkoi të ndërmarr veprimet e nevojshme për këtë rast.

Në raportin e policisë të Kosovës me nr 2014-GI-71 të datës 08.06.2014 theksohet se me datën 08.06.2014 hetuesit policor mbas marrjes së informacioneve se në furrën e bukës “Bereqeti” në Malishevë përkrahësit e subjektit politik Nisma për Kosovë janë duke zhvilluar aktivitete të jashtëligjshme që ndikojnë negativisht në procesin e votimit , rreth orës 14:00 kanë shkuar në vendin e ngjarjes ku me atë rast kanë gjetur brenda hapësirës së furrës së bukës “Bereqeti” ulur në një tavolinë katër persona: Ardian Mazreku, Haxhi Mazreku, Arben Krasniqi dhe Brahim Morina. Sipas raportit të policisë lokalë ku ndodheshin personat në fjalë ndodhej përball gjimnazit “Hamdi Berisha” në Malishevë objekti i së cilës ishte duke u shfrytëzuar si qendër e votimit. Gjithnjë sipas raportit të policisë tek personi Ardian Mazreku janë gjetur katër kopje të fletëvotimeve të printuara në kolor, ku në këto katër fletëvotimeve në katorrin me nr.59 të Nisma për Kosovë ka qenë e shënuar shenja “V” kurse në pjesën e numrave të kandidatëve kanë qenë të rrumbullakuar numrat 1, 17, 17, 44 dhe 65 si dhe janë gjetur edhe dokumente të tjera me emra të lagjeve të ndryshme, lista e anëtareve të KVV-ve, lista e vëzhguesve dhe lista e votuesve. Sipas raportit të policisë Ardian Mazreku deklaroi se është i caktuar nga subjekti politik Nisma për Kosovë të kryej detyrën e koordinatorit lokal zgjedhor në Malishevë , ndërsa personi tjetër Haxhi Mazreku deklaroi se ishte i caktuar nga subjekti politik Nisma për Kosovë si vëzhgues rezervë si dhe që të kryej detyrën për furnizim me ushqim për vëzhguesit dhe komisionarët e këtij subjekti politik.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore janë të bazuara pasi që Ardian Mazreku në cilësinë e koordinatorit lokal zgjedhor nga subjekti politik Nisma për Kosovë dega Malishevë ka kryer veprime të kundërligjshme sipas LZP-së ku nga ana e Policisë së Kosovës i janë gjetur katër kopje të fletëvotimeve të printuara në kolor ku të gjitha këto fletëvotime ishin të shënuara me disa numra të rrumbullakuar dhe të shënuara me shenjë për subjektin politik Nisma për Kosovë e cila mbante numrin 59 . Kjo vërtetohet edhe përmes raportit policor 2014-GI-71 të datës 08.06.2014 në të cilin përshkruhet në mënyrë të detajuar gjithë ngjarja e ndodhur para kësaj Qendre të Votimit gjatë ditës së zgjedhjeve.

PZAP-i duke vendosur për gjobën ka vendosur në pajtim me nenin 118 paragrafi 1 lidhur me nenin 120 paragrafi 1 pika c) të LZP, ku është paraparë se PZAP-i ndaj një subjekti politik mund të shqiptoj një gjobë deri në 50.000 €. PZAP-i është i bindur se me gjobën e shqiptuar do të arrihet qëllimi i gjobitjes për subjektin e lartë përmendur në veqanti, dhe për subjektet tjera që bëjnë shkelje të tilla të ligjit në përgjithësi. Ndërsa sa i përket ndalimit për pjesëmarrje në zgjedhje ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij vendimi , ka vendosur në pajtim me nenin 120.3 pika d) të LZP, me rast ka marrë në konsiderim se , shkelja ka ndodhur nga personi që ka qenë në dijeni me rregullat dhe procedurat e zgjedhore, rrethanë kjo që ka ndikuar në

shqiptimin dhe kohëzgjatjen e masës së ndalimit për personin e lartpërmendur në tërësi si në pikën III të dispozitivit.

Prandaj nga arsyet e lartcekura, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, dhe në pajtim me dispozitat e lartë përmendura ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 259/2014 më datën 11.06.2014

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*